

**Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar
Raporti i Audituesit të Pavarur dhe
Pasqyrat Financiare më dhe
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016**

PËRMBAJTJA

	Faqe
RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR	
PASQYRAT FINANCIARE:	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	4
PASQYRA E BURIMEVE DHE E PËRDORIMIT TË FONDEVE	5
PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË	6
SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE	7-16

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

Drejtuar Drejtimit dhe Këshillit Drejtues të Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar:

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (IEKA), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datën 31 dhjetor 2016, pasqyrën e burimeve dhe përdorimeve të fondeve dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të IEKA më datën 31 dhjetor 2016, dhe performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit të Organizatave Jofitimprurëse (SKK për OJF).

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga IEKA në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kodit të Etikës për Kontabilistët Profesionistë si dhe me kërkesat etike të aplikueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur edhe përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SKK për OJF, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e IEKA për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë IEKA ose të ndërpresë aktivitetin, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të IEKA.

Përgjegjësia e Audituesit për auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë periudhës së auditimit. Gjithashtu ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, planifikojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse për zbulimin e këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie si pasojë e mashtrimit është më i lartë, se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të atyre kontrolleve të brendshme relevante për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit në përputhje me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyetueshmërinë e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe zbulimeve përkatëse të bëra nga Manaxhimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë, të zbatuar nga Manaxhimi dhe, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, nëse ekziston një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet që mund të hedhin dyshime domethënëse mbi aftësinë e Shoqërië për të vazhduar sipas parimit të vijimësisë. Nëse arrijmë në përfundimin se një pasiguri materiale ekziston, ne jemi të detyruar të tërheqim vëmendjen në raportin e auditimit tek informacioni i paraqitur në shënimet shpjeguese të lidhura me pasqyrat financiare ose, nëse informacioni i paraqitur në shënimet shpjeguese është i pamjaftueshem, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona të auditimit bazohen në evidencat e auditimit të marra deri në datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund t'i shkaktojnë Shoqërisë ndërprerjen e vazhdimësisë në përputhje me parimin e vijimësisë.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare vjetore, duke përfshirë dhënien e informacioneve shpjeguese, si dhe nëse pasqyrat financiare vjetore paraqesin transaksionet dhe ngjarjet kryesore në mënyrë që të arrihet një paraqitje e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen e IEKA, përveç çështjeve të tjera, edhe objektin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi relevante në kontrollin e brendshëm të identifikur gjatë auditimit tonë.

Tiranë, Shqipëri

21 prill 2017

Partnerë angazhimi

Mirjeta Emni

Ekspert Kontabël i Autorizuar
Rruga Ibrahim Rugova, Tiranë
+355682021329

Rajmonda Reveli

Ekspert Kontabël i Autorizuar
Rruga Budi, Tiranë
+355682396755


Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar
Pasqyra e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2016

(Të gjitha shumat janë të shprehura në Lekë)

	Shënime	Ushtrimi i mbyllur 31.12.2016	Ushtrimi i mbyllur 31.12.2015
AKTIVE			
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare	4	78,512,003	71,962,600
Llogari të arkëtueshme	5	3,738,990	3,836,583
Inventarët	6	483,629	341,912
Të arkëtueshme të tjera (kuota variabël)	7	3,448,992	3,131,876
Shpenzime të periudhave të ardhshme	11	215,590	31,800
Totali i aktiveve afatshkurtra		86,399,204	79,304,771
Aktive afatgjata			
Aktive afatgjata materiale	8	39,156,280	40,477,783
Totali i aktiveve afatgjata		39,156,280	40,477,783
TOTALI I AKTIVEVE		125,555,484	119,782,554
DETYRIMET			
Detyrime afatshkurtra			
Llogari të pagueshme	9	5,977,248	4,981,536
Detyrime ndaj Autoritetit të Çertifikimit	9	7,331,739	6,173,734
Detyrime të tjera (kuota variabël)	7	610,580	760,778
Detyrime tatimore	10	246,230	256,081
Të ardhura të periudhave të ardhshme	11	755,946	1,024,685
Totali i detyrimeve afatshkurtra		14,921,743	13,196,814
TOTALI I DETYRIMEVE		14,921,743	13,196,814
PASURIA NETO	12	110,633,741	106,585,740

Shënimet nga faqja 7 deri në 16 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare

Këto pasqyra financiare janë autorizuar nga Këshilli Drejtues me vendimin nr. __, datë __.04.2017 dhe nënshkruar në emër të tij nga:



Hysen ÇELA
Kryetar i Këshillit Drejtues



Elvira HOXHA
Drejtor Ekzekutiv

Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar
Pasqyra e burimit të fondeve për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
(Të gjitha shumat janë të shprehura në Lekë)

	Shënime	Ushtrimi i mbyllur 31.12.2016	Ushtrimi i mbyllur 31.12.2015
BURIMET E FONDEVE			
Burime nga veprimtaritë kryesore	13	30,347,323	30,208,171
i. Kuotat e anëtarësimit E.K.R., shoqëri dhe stazhiere		28,937,224	29,100,056
ii. Të ardhura të tjera		1,410,099	1,108,115
Burimet nga kualifikimi E.K.R.dhe stazhierë	15	2,410,500	2,076,350
Burimet nga publikimet	16	219,800	701,400
Totali i burimeve		32,977,623	32,985,921
PERDORIMET E FONDEVE			
Përdorimet për veprimtarinë kryesore	14	(27,168,152)	(23,527,756)
i. Pagat, sigurimet shoqërore të personelit dhe të ngjashme		(5,383,985)	(5,701,296)
ii. Honorare të Drejtimit, Autoritete, Komitete etj		(5,860,708)	(5,893,860)
iii. Shpenzime administrative dhe të tjera		(15,923,459)	(11,932,600)
Shpenzime kualifikimi E.K.R. dhe stazhierë	15	(2,912,296)	(2,870,518)
Shpenzime për botime	16	(63,284)	(300,933)
Totali i përdorimit të fondeve		(30,143,732)	(26,699,207)
Teprica (defiçiti) i burimeve nga veprimtaritë kryesore		2,833,891	6,286,714
Të ardhura nga kursi i këmbimi		100,740	12,051
Të ardhura nga interesat		1,113,370	673,529
Të ardhura (shpenzime) financiare		1,214,110	685,580
Teprica neto e burimeve për vitin	17	4,048,001	6,972,294
Aktivitet neto në fillim të vitit		106,585,740	99,613,446
Aktivitet neto në fund të vitit		110,633,741	106,585,740

Shënimet nga 7 deri në 16 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar
Pasqyra e rrjedhës së parasë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(Të gjitha shumat janë të shprehura në Lekë)

	Ushtrimi i mbyllur 31.12.2016	Ushtrimi i mbyllur 31.12.2015
Rrjedha e parasë nga veprimtaritë e shfrytëzimit		
Përdorime të fondeve për vitin	4,048,001	6,972,294
Rregullime për:	1,988,913	3,683,863
<i>Amortizimin</i>	<i>1,988,913</i>	<i>3,753,863</i>
<i>Fitimin nga shitja e aktiveve afatgjata materiale</i>	<i>-</i>	<i>(70,000)</i>
Rritje/rënie në aktivet afatshkurtra	(545,030)	(1,769,733)
Rritje/rënie në detyrimet afatshkurtra	1,724,929	489,928
Rrjedha e parasë e përfituar nga aktivitetet e shfrytëzimit	7,216,813	9,376,352
 Rrjedha e parasë nga veprimtaritë investuese		
Blerja e aktiveve afatgjata materiale	(667,410)	(983,704)
Shitja e aktiveve afatgjata materiale	-	70,000
Rrjedha e parasë e përdorur në aktivitetet investuese	(667,410)	(913,704)
 Rrjedha neto e parasë	6,549,403	8,462,648
 Mjetet monetare në fillim të vitit (Shënimi 4)	71,962,600	63,499,952
 Mjetet monetare në fund të vitit (Shënimi 4)	78,512,003	71,962,600

Shënimet nga 7 deri në 16 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. Informacion i përgjithshëm

Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (më poshtë “IEKA” ose “Instituti”), është një shoqatë profesionale që grupon Ekspertët Kontabël të Regjistruar dhe Shoqëritë Audituese që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në Republikën e Shqipërisë. IEKA është krijuar në bazë të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1, datë 2 tetor 1995 dhe është regjistruar me Vendimin e Gjykatës së rrethit Tiranë nr. 3573, datë 16 tetor 1998. Instituti ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me Ligjin nr.10091, datë 5 mars 2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertëve kontabël të regjistruar dhe të kontabilistëve të miratuar”, me Ligjin për “Organizatat jo-fitimprurëse” dhe me statutin e tij.

Veprimtaria kryesore e Institutit ka për qëllim të sigurojë që profesioni i Ekspertëve Kontabël të Regjistruar vepron në përputhje me interesat e publikut si dhe të mbrojë etikën dhe pavarësinë e anëtarëve të tij. Veprimtaria e Institutit mbikëqyret nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike. Selia e Institutit ndodhet në “Rruga e Elbasanit”, pallati Edil Al - IT, zyra 321, Tiranë, Shqipëri.

2. Baza e përgatitjes

(a) Deklarata e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në politikat kontabël të përshtatura nga Këshilli Drejtues dhe Asambleja e Përgjithshme për qëllime të raportimit të IEKA si dhe në përputhje me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit të Organizatave Jofitimprurëse (SKK për OJF) në fuqi nga 1 Janar 2016. Zbatimi i SKK për OJF nuk ka ndikim në informacionin krahasues për vitin 2015.

Politikat kontabël si më poshtë paraqesin të plotë bazën e përgatitjes së pasqyrave financiare.

(b) Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike.

(c) Ndryshim i politikës kontabile për njohjen e të ardhurave nga kuota variabile

Mbështetur në vendimin nr. 14, datë 28 dhjetor 2012 të Këshillit Drejtues, në 1 janar 2013 Instituti ndryshoi politikën e njohjes së të ardhurave për kuotën variabël. Sipas këtij vendimi shumatat e të drejtave/detyrimeve lidhur me deklaratimet dhe pagesat e kuotës variabël të EKR të azhornuara deri më 31 Dhjetor 2015 janë përfshirë në llogaritë përkatëse të EKR-ve dhe shoqërive të auditimit.

Në përputhje me politikën e re kontabël të ardhurat nga kuota variabël do të njihen në momentin e deklaratimit të kuotës variabël në shumatat e përlogaritura bazuar në tabelat e misionëve të deklaruara prej EKR-ve dhe shoqërive të auditimit dhe pagesat e kryera gjatë vitit do të ulin detyrimin për kuotën variabël të deklaruar e të papaguar.

(d) Vijueshmëria

Pasqyrat financiare janë përgatitur sipas parimit të vijueshmërisë. Sipas këtij parimi, IEKA parashikon se veprimtaria e saj do të ketë vijimësi në mënyrë të mjaftueshme që të plotësojë objektivat dhe angazhimet dhe se nuk ka në plan ose nuk do të ketë të nevojshme të ndërpresë aktivitetin e saj në një të ardhme të afërt.

3. Përmbledhje e politikave kryesore kontabël

(a) Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Pasqyrat financiare të Institutit janë prezantuar në Lekë shqiptar (Lekë), e cila është monedha funksionale e Institutit. Informacioni financiar është paraqitur në Lekë.

3. Përmbledhje e politikave kryesore kontabël (vazhdim)

Parimet kontabël kryesore të përdorura për përgatitjen e pasqyrave financiare janë si më poshtë:

(b) Njohja e burimeve dhe përdorimit të fondeve

Burimet financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 janë njohur mbi bazën e parimit të të drejtave të konstatuara, për kuotën fikse vjetore për çdo anëtar dhe për kuotat variabël të llogaritura si përqindje mbi të ardhurat bruto të realizuara nga secili anëtar. Shuma e kuotës fikse dhe përqindjes së kuotës variabël janë përcaktuar me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve të datës 30 qeshor 2010 (vendimi nr. 73). Masa e kuotës fikse dhe asaj variabël janë respektivisht si më poshtë:

	2016	2015
Kuota fikse	100,000	100,000
Kuota variabël	0.5%	0.5%

Në burimet e Institutit përfshihen edhe të ardhurat nga veprimtari të tjera, siç janë publikimet profesionale, nga kualifikimi i vijueshëm dhe nga anëtarët e rinj. Për secilën kategori të këtyre burimeve të fondeve është paraqitur edhe shuma përkatëse e përdorimeve.

Përdorimet e fondeve të njohura në pasqyrat financiare përfshijnë të gjitha pagesat e bëra gjatë vitit dhe shpenzimet e kryera për vitin por që nuk janë paguar në fund të vitit.

(c) Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj regjistrohen me kursin e datës së kryerjes së transaksionit.

Aktivitet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj janë përkthyer me kursin e këmbimit të Bankës së Shqipërisë në fund të vitit. Diferencat nga kursi i këmbimit të lindura nga përkthimi njihen në pasqyrën e burimeve dhe përdorimit të fondeve. Kursi i këmbimit për dy monedhat e huaja kryesore me monedhën vendase sipas kursit të Bankës së Shqipërisë më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015, ka qënë respektivisht si më poshtë:

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
U.S. Dollar (USD)	128.17	125.79
Euro (Euro)	135.23	137.28

(d) Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë gjendjen në arkë, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në para në banka, të cilat janë për një afat maturimi më pak se një vit.

(e) Llogaritë e arkëtueshme dhe llogaritë e pagueshme

Llogaritë e arkëtueshme dhe llogaritë e pagueshme në fund të vitit janë paraqitur me koston e tyre historike. Instituti ka filluar të përlllogarisë vlera të arkëtueshme nga kuotat fikse të anëtarëve vetëm më 31 dhjetor 2012.

4. Përmbledhje e politikave kryesore kontabël (vazhdim)

(f) Aktivet afatgjata materiale

Aktivitet afatgjata materiale paraqiten me vlerën e tyre historike minus amortizimin e akumuluar. Politika e llogaritjes së zhvlerësimit ka filluar të aplikohet për herë të parë nga 1 janari 2009. Shtesat e aktiveve afatgjata regjistrohen në kontabilitet me koston e marrjes ose të blerjes të tyre. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë aktivin në vendin dhe kushtet ekzistuese.

Amortizimi është llogaritur me metodën lineare mbi jetën e dobishme të vlerësuar të aktivitet, duke aplikuar normat e mëposhtme të amortizimit (sipas IEKA-s):

Kategoria e aktiveve fikse	Normat e amortizimit	
	2016	2015
Ndërtesa	5%	5%
Mjete transporti	20%	20%
Pajisje zyre	20%	20%
Pajisje kompjuterike	25%	25%

Për vitin 2011, është aplikuar llogaritja e zhvlerësimit për herë të parë për ndërtesat.

(g) Teprica dhe defiçiti i burimeve

Teprica / defiçiti midis burimeve dhe përdorimeve, që krijohet gjatë vitit, pasqyrohet në pasurinë neto të IEKA.

(h) Tatimi mbi fitimin

IEKA është institut jofitimprurës. Si i tillë, Instituti nuk paguan tatim mbi fitimin. Instituti respekton dispozitat e ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat në Republikën e Shqipërisë” në lidhje me tatimin mbi të ardhurat personale dhe tatimin në burim.

(i) Kontributet për sigurimet dhe Fondi i pensioneve

Shoqëria paguan kontributet për pensione si dhe për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore për punonjësit e saj, siç është parashikuar në legjislacionin shqiptar. Kontributet, bazuar në pagat, janë paguar në llogari të organizmave kombëtare përgjegjëse për pagesën e pensioneve dhe sigurimeve shëndetësore. Nuk ka asnjë detyrim tjetër në lidhje me fondin për pensione dhe sigurimet shëndetësore.

Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
(Të gjitha shumat janë të shprehura në Lekë)

5. Mjete monetare

Gjendja e mjeteve monetare më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 është si më poshtë:

	Ushtrimi i mbyllur 31 dhjetor 2016	Ushtrimi i mbyllur 31 dhjetor 2015
Paraja në bankë		
Intesa SanPaolo (Lekë)	13,894,129	13,775,769
Intesa SanPaolo (Euro)	379,420	6,705
Intesa SanPaolo (USD)	26,753	33,804
Shuma ekuivalente në Lekë	14,300,302	13,816,278
Banka Kombëtare Tregtare (Lekë)	74,340	83,009
Banka Kombëtare Tregtare (Euro)	207,456	43,251
Banka Kombëtare Tregtare-Provimet (Lekë)	5,793,768	6,638,357
Shuma ekuivalente në Lekë	6,075,564	6,764,617
Raiffeisen Bank (Lekë)	15,601,046	10,070,382
Raiffeisen Bank (USD)	51,781	59,122
Shuma ekuivalente në Lekë	15,652,827	10,129,504
Depozita me afat	42,116,589	41,126,968
Totali në bankë	78,145,282	71,837,367
Paraja në arkë		
Paraja në arkë (Lekë)	120,248	79,219
Paraja në arkë (Lekë)	148,798	29,642
Paraja në arkë (Euro)	88,575	7,441
Paraja në arkë (USD)	9,100	8,931
Totali në arkë	366,721	125,233
Totali	78,512,003	71,962,600

Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
(Të gjitha shumat janë të shprehura në Lekë)

4. Mjete monetare (vazhdim)

Mjetet monetare të investuara në depozita, sipas afatit të maturimit, paraqiten si më poshtë:

	Ushtrimi i mbyllur 31 dhjetor 2016	Ushtrimi i mbyllur 31 dhjetor 2015
Depozita me afat 12 muaj		
Banka Kombëtare Tregtare	15,607,082	15,027,237
Intesa SanPaolo	7,500,000	7,500,000
Credins Bank	19,009,507	18,599,731
Totali	42,116,589	41,126,968

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 të ardhurat nga interesi janë 1,113,370 Lekë (31 dhjetor 2015: 673,529 Lekë).

5. Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 janë të detajuara si më poshtë:

	Ushtrimi i mbyllur 31 dhjetor 2016	Ushtrimi i mbyllur 31 dhjetor 2015
E.K.R. kuotë fikse pjesore	2,429,870	1,832,670
E.K.R. pasiv, kuotë fikse	1,854,914	1,965,413
Kërkesa të tjera për t'u arkëtuar	36,000	38,500
Provizion për kuotat e papaguara	(581,794)	-
Totali	3,738,990	3,836,583

Provizioni është krijuar për kuotat e papaguara të disa E.K.R. të cilët kanë dalë tashmë në pension.

6. Inventarët

Inventarët janë të përbërë si më poshtë:

	Ushtrimi i mbyllur 31 dhjetor 2016	Ushtrimi i mbyllur 31 dhjetor 2015
Kodi Etikës	910	6,370
SNA	54,080	68,640
Guida	91,350	91,350
Revista	18,734	57,928
Udhërrëfyesi	100,055	104,124
SNA mbi raportin e auditorit të pavarur	204,000	-
Të tjera	14,500	13,500
Totali	483,629	341,912

Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(Të gjitha shumat janë të shprehura në Lekë)

7. Të arkëtueshme të tjera (kuota variabël)

Të arkëtueshme të tjera përfaqësojnë të drejtat e Institutit ndaj anëtarëve të tij në lidhje me kuotën variabël. Këto të drejta lindin kur anëtarët e Institutit kanë paguar më pak se misionet e deklaruara. Llogari të arkëtueshme të tjera më 31 dhjetor 2016 janë 3,448,992 Lekë (31 dhjetor 2015: 3,131,876 Lekë).

Detyrime të tjera përfaqësojnë detyrimet e Institutit ndaj anëtarëve të tij për kuotën variabël. Këto detyrime lindin kur anëtarët e Institutit kanë paguar më shumë se misionet e deklaruara. Detyrimet për kuotën variabël më 31 dhjetor 2016 janë 610,580 Lekë (31 dhjetor 2015: 760,778 Lekë).

8. Aktive afatgjata materiale

Aktivitet afatgjata materiale më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 paraqiten si më poshtë:

	Ndërtesa	Mjete transporti	Mobilje dhe pajisje elektronike	Total
Kosto				
Gjendja më 31 Dhjetor 2015	47,455,444	3,273,550	9,214,250	59,943,244
Shtesa	-	-	667,410	667,410
Pakësime	-	-	-	-
Gjendja më 31 Dhjetor 2016	47,455,444	3,273,550	9,881,660	60,610,654
Amortizimi i akumuluar				
Gjendja më 31 dhjetor 2015	10,440,494	791,108	8,233,858	19,465,460
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-	-	-
Amortizimi vitit	949,408	654,710	384,795	1,988,913
Gjendja më 31 dhjetor 2016	11,389,902	1,445,818	8,618,653	21,454,373
AAM Vlera Kontabël Neto				
Gjendja më 31 Dhjetor 2015	37,014,950	2,482,443	980,392	40,477,783
Gjendja më 31 Dhjetor 2016	36,065,542	1,827,732	1,263,007	39,156,280

Zëri “Ndërtesa” rezulton me vlerë bruto 47,455,444 Lekë më 31 dhjetor 2016. Ende nuk është marrë titulli i pronësisë për zyrat e IEKA nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme. Megjithatë, ato janë konsideruar si aktive afatgjata materiale të IEKA-s.

Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
(Të gjitha shumat janë të shprehura në Lekë)

9. Llogari të pagueshme dhe detyrime ndaj Autoritetit të Çertifikimit

	Ushtrimi i mbyllur 31 dhjetor 2016	Ushtrimi i mbyllur 31 dhjetor 2015
<i>Komitete dhe Borde:</i>		
Komiteti i Cilësisë	1,004,999	902,000
Bordi i Mbrojtjes Publike	840,000	840,000
Komiteti i Edukimit	-	44,700
Këshilli i Drejtimit	27,000	27,000
Totali	1,871,999	1,813,700
<i>Furnitorë:</i>		
Vitrina Franceze	2,226,250	-
EDIL AL-IT	609,594	609,594
Detyrime për AC	576,504	714,431
Kandidatë KM tarifë regjistrimi në provime	132,000	132,000
Albpaper	204,000	-
Detyrime ndaj të tretëve	58,000	33,934
APG shpk	-	983,704
Geci shpk	-	463,200
Të tjerë	298,901	230,973
Totali	4,105,249	3,167,836
Totali llogari të pagueshme	5,977,248	4,981,536

Të pagueshme ndaj Autoritetit të Çertifikimit përfaqëson detyrime për t'u paguar nga IEKA për tarifat e regjistrimit të provimit që lidhen me procesin e çertifikimit.

	Ushtrimi i mbyllur me 31 dhjetor 2016	Ushtrimi i mbyllur me 31 dhjetor 2015
Teprica e vitit të kaluar	6,173,734	5,511,523
Teprica (defiçiti) i vitit	1,158,005	662,211
Totali i detyrimeve për Autoritetin e Çertifikimit	7,331,739	6,173,734

Pasqyrat financiare të burimeve dhe të përdorimit të fondeve të procesit të çertifikimit janë përgatitur në përputhje me Ligjin nr. 10091, datë 5 maj 2009 "Për auditimin ligjor..." dhe ndryshimet e tij. Diferenca midis burimeve dhe përdorimeve të vitit 2016 paraqet një shtesë prej 1,158,005 Lekë (ndersa për vitin 2015 një shtesë prej 662,211 Lekë). Totali neto i cili përfshin edhe atë të trashëguar nga vitet e kaluara ndodhet në llogaritë bankare pranë Bankës Kombëtare.

Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
(Të gjitha shumat janë të shprehura në Lekë)

10. Detyrime tatimore

	Ushtrimi i mbyllur 31 dhjetor 2016	Ushtrimi i mbyllur 31 dhjetor 2015
Tatimi mbi të ardhurat	174,279	181,087
Sigurime shoqërore	71,951	74,994
Totali	246,230	256,081

11. Të ardhura dhe shpenzime të periudhave të ardhshme

IFAC, IEKA dhe SHKÇAK kanë lidhur një marrëveshje trepalëshe me qëllim uljen e kostove të përkthimit si dhe në kuadër të unifikimit të terminologjisë profesionale me fushëveprimi përkthimet e dokumentave të Bordeve të IFAC siç janë Guidat, Kodet e Etikës dhe dokumenta e propozime të tjera të publikuara nga IFAC. Shuma prej 599,300 Lekë e cila është balancë çelje në 1 janar 2016 e të ardhurave të periudhave të ardhshme është pakësuar me shumën 363,504 Lekë për përkthime të SNA dhe Kodit të Etikës gjatë vitit 2016. Shuma më 31 dhjetor 2016 për t'u përdorur në vitet e ardhshme mbetet 235,796 Lekë. Në të ardhura të periudhave të ardhshme janë grupuar edhe disa pagesa të kuotave të kryera më tepër (kuota fikse të E.K.R., kuota të stazhierëve, të kandidatëve për provime EKR/KM etj.) që do të konsiderohen për vitin në vijim në shumën 520,150 Lekë.

Në shpenzime të periudhave të ardhshme më 31 dhjetor 2016 përfshihet një parapagim i bërë për ICAEW në shumën prej 215,590 Leke. Në 31 dhjetor 2015 shuma prej 31,800 Lekë paraqet shpenzime të parapaguara për karburant.

12. Ndryshime në pasurinë neto

Gjatë vitit 2016 pasuria neto e IEKA-s është shtuar me shumën 4,048,001 Lekë që është teprica e burimeve të vitit financiar.

13. Burimet e fondeve nga veprimtaria kryesore

Burimet e fondeve për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 janë të përbëra si më poshtë:

	Ushtrimi i mbyllur 31 dhjetor 2016	Ushtrimi i mbyllur 31 dhjetor 2015
Përshkrimi		
Nga kuota fikse E.K.R.	22,252,780	22,403,873
Nga kuota variabël E.K.R.	3,899,444	4,711,183
Nga kuota e regjistrimit në stazh	2,550,000	1,750,000
Nga kuota e regjistrimit të shoqërive	235,000	235,000
Nga kuota fikse E.K.R. pasiv	308,065	255,333
Të ardhura të tjera	1,102,034	852,782
Totali	30,347,323	30,208,171

Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(Të gjitha shumat janë të shprehura në Lekë)

13. Burimet e fondeve nga veprimtaria kryesore (vazhdim)

Në Janar të vitit 2015, me hyrjen në fuqi të ndryshimit të Statutit të IEKA për afatin e deklarimit të misionëve të EKR dhe shoqërive (nga 31 mars u vendos në 25 janar) u regjistruan në të ardhurat nga kuota variabël edhe të ardhurat sipas deklarimit të misionëve për vitin 2014.

Të ardhurat nga kuota variabël përfaqësojnë të ardhurat sipas deklarimit të misionëve të EKR-ve për vitin 2016/2015. Kuotat e E.K.R. pasiv të arkëtueshme (te pambledhura deri më 31 dhjetor 2016/2015) nuk janë regjistruar në të ardhura meqenëse Drejtimi i Institutit vlerëson si mjaft të vështirë mbledhjen e tyre. Ne te ardhurat e periudhës janë perfshirë vetëm kuotat e EKR-ve pasive te arketuara. Një pjesë e E.K.R. pasiv ndodhet jashtë Shqiperisë, një pjesë tjetër nuk paguajnë dhe nuk ka një mekanizëm që t'i detyrojë këta E.K.R. të kryejnë pagesën gjatë periudhës që janë pasiv.

14. Përdorimet e fondeve për veprimtarinë kryesore

	Ushtrimi i mbyllur 31 dhjetor 16	Ushtrimi i mbyllur 31 dhjetor 15
Përdorimet e fondeve për veprimtarinë kryesore		
Pagat e punonjësve	3,579,275	4,141,455
Sigurimet shoqërore	469,650	551,841
Të tjera	1,335,060	1,008,000
Nën totali - Pagat e punonjesve, sigurimet shoqërore dhe të ngjashme	5,383,985	5,701,296
Honorare drejtimi, KKB, Audituesi i PF	3,990,708	4,290,660
Honorare për Autoritetin e Regj. dhe komitete	1,870,000	1,603,200
Nën totali - Drejtimi, Autoritetet, Honoraret e Komiteteve	5,860,708	5,893,860
Shpenzime udhëtimi turistik	5,502,250	2,135,700
Shpenzime amortizimi	1,988,913	3,753,863
Kuota regjistrimi në organizma profesionale	2,003,850	1,277,420
Udhëtime e dieta	2,027,186	1,664,739
Telefon, internet	319,293	426,113
Energji, ujë	232,010	295,964
Kancelari	464,909	127,000
Shpenzime të tjera	3,385,048	2,251,801
Nën totali - Shpenzime admin. dhe të tjera	15,923,459	11,932,600
Totali	27,168,152	23,527,756

Më 31 dhjetor 2016 Instituti ka 4 punonjës me kohë të plotë (31 dhjetor 2015: 4 punonjës me kohë të plotë).

Diferenca midis Burimeve nga veprimtaria kryesore (Shënimi 13) dhe Përdorimeve nga veprimtaria kryesore (Shënimi 14) përbën Tepicën nga veprimtaria kryesore prej 3,179,171 Lekë (2015: 6,680,415 Lekë).

Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(Të gjitha shumat janë të shprehura në Lekë)

15. Burimet dhe përdorimet e fondeve për kualifikimin e E.K.R. dhe stazhierëve

	Ushtrimi i mbyllur 31 dhjetor 2016	Ushtrimi i mbyllur 31 dhjetor 2015
Burimet e fondeve nga kualifikimi E.K.R.	219,000	140,000
Burimet e fondeve nga stazhierët	1,565,500	1,339,350
Burimet nga trajnimi SKK/SNK	626,000	597,000
Totali	2,410,500	2,076,350
Përdorimet e fondeve për kualifikimin e E.K.R.	(1,183,476)	(1,105,908)
Përdorimet e fondeve për kualifikimin e stazhierëve	(1,341,820)	(1,342,510)
Përdorimet nga trajnimi SKK/SNK	(387,000)	(422,100)
Totali	(2,912,296)	(2,870,518)
Teprica nga kualifikimet për E.K.R. dhe stazhierët	(501,796)	(794,168)

16. Burime dhe përdorime nga botimet

	Ushtrimi i mbyllur 31 dhjetor 2016	Ushtrimi i mbyllur 31 dhjetor 2015
Totali i të ardhurave nga botimet	219,800	701,400
Totali i shpenzimeve nga botimet	(63,284)	(300,933)
Teprica / (defiçiti) nga botimet	156,516	400,467

17. Teprica / (defiçiti) neto i burimeve të vitit

	Ushtrimi i mbyllur 31 dhjetor 2016	Ushtrimi i mbyllur 31 dhjetor 2015
Teprica nga veprimtaria kryesore	3,179,171	6,680,415
Teprica / (defiçiti) nga kualifikimet	(501,796)	(794,168)
Teprica / (defiçiti) nga botimet	156,516	400,467
Të ardhura financiare	1,214,110	685,580
Teprica / (defiçiti) i vitit	4,048,001	6,972,294

18. Ngjarje pas datës së raportimit

Nuk ka ndonjë ngjarje pas datës 31 dhjetor 2016 e cila kërkon ndonjë paraqitje apo rregullim në pasqyrat financiare.